

THE REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER FOR CENTRAL AND EASTERN EUROPE
BOTIM I QENDRES RAJONALE TE MJEDISIT PER EVROPEN QENDRORE DHE LINDORE - ZYRA NE
KOSOVË

PERMBAJTJA

- 2 Vazhdimi i stërvitjeve për Shoqatat Lokale Mjedisore
 - 3 Shoqata e Ekologëve - Pejë
 - 4 OJQ-të e regjionit të frustruara nga indolencia në Hagë
 - 5 Urani i varfëruar në Kosovë
 - 6 Lajme dhe programe nga Zyra e REC-ut në Kosovë
 - 7 Shkollat mjedisore verore
 - 8 OJQ-të mjedisore nga regjioni
- "International Agenda", faqe 8, versioni anglisht

Financuar nga



22 Prill

Dita Ndërkombëtare e Tokës

Regjistroni planin tuaj për Ditën e Tokës në:

<http://www.earthday.net>

Çdo aksion i ndërmarrë për Ditën e Tokës është i rëndësishëm. Planet e tuaja gjithashtu mund ti dërgoni në e-mail adresën:

worldwide@earthday.net



Foto: Shoqata e Ekologëve - Pejë

REC Kosova miraton projekt-propozime nga OJQ-të mjedisore

Qendra Rajonale e Mjedisit Zyra në Kosovë, në kuadër të Programit të saj të Ndhimave Lokale, të financuara nga Ministria e Mjedisit e Holandës, ka miratuar një numër projekt-propozimesh të paraqitura nga OJQ vendore. Bordi Këshillimor i REC, në mbledhjen e tij të datës 20 mars 2001, ndërmjet 19 projekteve të paraqitura ka miratuar 7 prej tyre (shih tabelën e më poshtme). Projektet e miratuara synojnë një sërë aktivitetesh në përfshirje të komunitetit, vlerësim dhe promovim të vlerave natyrore vendore dhe veprime konkrete për ruajtjen apo përmirësimin e mjedisit ku jetojmë

SG01001: "Decora Bozhur", 3600 DEM, "Kosova's Knot", Mitrovica

SG01002: "Ndërlidhja e OJQ-ve mjedisore të Kosovës", 3826 DEM, "Shoqata për Mbrojtjen e Ambientit AQUILA", Pejë

SG01003: "Vendos paqe me natyrën", 5915 DEM, "Vizioni Rinor", Prizren

SG01009: "Ngritja e vetëdijes shoqërore për ruajtjen e natyrës dhe mjedisit jetësor përmes organizimit të ligjeratave në vendet e rrezikuara në natyrë", 4220 DEM, "Shoqata bjeshkatëre dhe skitare SHARRI - INT", Prizren

SG01011: "Formimi i sistemit informues BURZA E MBETURINAVE dhe shërbimit ECO-SOS për veprim intervenues", 5950 DEM, "EKO-QENDRA për zhvillim të qëndrueshëm", Prishtinë

SG01013: "Llojet e rralla bimore dhe shtazore të Kosovës", 4144 DEM, "Eko-Klina", Klinë

SG01017: "Zgjate jetën", 2345 DEM, "Shoqata alternative rinore MILLENIUM", Dardanë



Vazhdimi i stërvitjeve për Shoqatat Lokale Mjedisore

Dy ciklet e fundit të stërvitje për OJQ-të vendore të organizuar nga Zyra e REC-ut në Kosovë në bashkëpunim me MCIC, u mbajt në Prishtinë, nga 15 deri 19 Janari, 2001 dhe 26 deri 30 Marsi, 2001.

Pjesëmarrësit

Në këto stërvitje morrën pjesë përfaqësues të OJQ-ve mjedisore, institute që merren me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, si dhe individ përkatësisht student që kanë shfaqur interesim për këto çështje.



Temat e diskutuara

Si edhe në stërvitjet e mëparshme edhe në këtë cikël, temat që u diskutuan ishin: roli i OJQ-ve, autoriteteve lokale dhe institucioneve mjedisore në shoqëri, shembuj të pjesëmarrjes publike dhe drejtës së publikut për tu informuar, krijimi i rrjetës dhe kooperimi i tyre. Temat që

paraqesin probleme themelore për OJQ-të si: përpilimi i projekt propozimit, menaxhimi i projektit, planifikimi strategjik, komunikimi me donatorë, prezentimi i organizatës, gjithashtu u diskutuan.

Si rezultat i punës ekipore të grupeve që morrën pjesë, ishte edhe "GAZETA E MURIT". Të gjithë pjesëmarrësit përgaditën shkrime

të tyre, ku paraqitën problemet më akute në mjedisin që jetojnë si dhe zgjidhjet e mundshme të atyre problemeve.

Vlerësimi

Vlerësimi i përgjithshëm për këto dy cikle të stërvitjeve ishte tejet pozitiv, dhe pjesëmarrësit shprehën dëshirën që të marrin pjesë përsëri në stërvitjet e ardhshme.



“REC BULLETIN” është botim periodik i Qendrës Rajonale të Mjedisit - Zyra në Kosovë”

Qendra Regjionale e Mjedisit - Zyra në Kosovë,
ka ndërruar adresën. Tani gjendemi në:

Bregu i Diellit I, Rruga 3, Shtëpia nr.1
tel: 038/552-123, e-mail:rec_kos@yahoo.co.uk

Christy Duijvelaar - Drejtoreshë
Shkipe Deda - Drejtuese Projekti
Florina Skeja - Drejtuese e financave
Hans Nordstrand - Drejtues Projekti
Blerim Vela - Referent për informata
Aleksandar Savic - Referent për Projekte
Mrika Maliqi - Asistente për Trajnime



Shoqata e Ekologëve - Pejë

Në këtë rubrikë, OJQ-të mjedisore të Kosovës kanë rastin të paraqesin organizatën dhe aktivitetin e tyre. Nëse dëshironi të prezentoni OJQ-në tuaj në Buletinin e REC-ut, artikullin tuaj mund ta dorëzoni në Zyren e REC-ut në Kosovë

Shoqata e Ekologëve - Pejë (SHEP), është formuar në vitin 1990, nga një grup i intelektualëve të Pejës, të cilët të shtyrë nga problemet e mëdha ekologjike, vendosën që të formojnë këtë organizatë dhe të marrin masa për mbrojtjen e ambientit në rrethin e Pejës.

Por, për shkak të pamundësisë që të veprojnë ata përkohësisht ndalën veprimtarinë e tyre, dhe përsëri u riaktivizuan, në vitin 1999. Me përbërje të re, kjo organizatë ka edhe organet e veta si Kuvendin me 200 anëtarë të evidencuar, dhe Bordin prej 7 anëtarëve, me kryetar Afrim Sanaja.

Problemet e grumbulluar si pasojë e luftës, dhe problemet e krijuar pas luftës bën që në qytetin e Pejës, problemet ekologjike të jenë të mëdha. Mbeturinat, prerja e pakontrolluar e pyjeve, numri i madh i automjeteve, shkatërrimi i parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara, mungesa e ligjit për mjedis, janë vetëm disa nga problemet me të cilat ballafaqohen sot qytetarët e Pejës. Për zgjidhjen e këtyre problemeve në mënyrë aktive po merret edhe Shoqata e Ekologëve - Pejë.

Aktiviteti

Aktiviteti i kësaj organizate është tejet i madh. Aktiviteti i parë i kësaj organizate kishte të bënte me problemin e prerjes së drunjëve, ata me anë të proklacioneve, posterëve si dhe akcionit "Një bredh për tërë qytetin", informuan dhe vetëdijësuan qytetarët me këtë problem të madh.

Në vazhdim ata gjithashtu organizuan një tryezë të rrumbullakët me përfaqësuesit e UNMIK-ut, OSBE-së, OJQ-ve të vendit dhe ndërkombtare, instituteve të ndryshme që veprojnë në Pejë, për problemet ekologjike. Aktiviteti i rëndësishëm i tyre ishte edhe organizimi i karnevalit ekologjik me nxënësit e shkollave fillore, me moton "Mos më këput, se jam i yti". Pastaj aktiviteti "Ta mbrojmë ambientin tonë shkollor", ku në bashkëpunim me shkollën fillore "Xhemajl Kada", u bë rregullimi i disa oazave të gjelbërta, vendosja e shportave metalike, ulëseve etj.

Në listën e gjatë të aktiviteteve të kësaj organizate përfshihet edhe vendosja e 12 urdhëresave ekologjike në qytetin e Pejës, trajnimi dhe formimi i celulave të ekologëve të rinj në regjionet rurale (Loxhë, Krushë, Raushiq), ku ligjerata kanë mbajtur ekspertë nga mjekësia, ekologjia dhe drejtësia.

Realizimi i gjitha këtyre projekteve, ata e bën me ndih-



Karnevali ekologjik, Pejë



Anëtarët e SHEP

mën e organizatave: CDF, REC, USAID, IRC, GER, Departamenti për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i komunës së Pejës si dhe organizata të tjera.

Informata për kontaktim

SHOQATA E EKOLOGËVE - PEJË

Adresa: Sheshi i Republikës, Shtëpia e mallrave, kati i III-të,

Personi për kontaktim: Hasret Latfi,

Tel: 044/141-581, 044/150-444, 039/22-625



OJQ-të e regjionit të frustruara nga indolencia në Hagë

Nga: Pavel Antonov

Një dështim i pastër. Pa vendime. Maskaradë. Ky është fjalori që është përdorur nga aktivistët e regjionit për të përshkruar rezultatet e Mbledhjes për Ndryshim të Klimatike në nëntor në Hagë.


Përderisa ata ishin të frustruar për mungesën e konsensusit ndërkombëtar, anëtarët e OJQ-ve nga Evropa Qëndrore dhe Lindore (CEE), duhej të pranonin se procesi ishte i më tepër i mirëseardhur nga ana e grupeve jo fitim prurëse se sa punët mjedisore në të cilat ata ishin involvuar. Ata gjithashtu u pajtuan me përfundimet e marra se qerevitë e shteteve të tyre ishin duke marrë masa lidhur me çështjen, gjë që nuk vlen edhe për sektorin jo fitim prurës të regjionit.

Prezenca e organizatave joqeveritare në Hagë ishte më se e dukshme, të cilët me anë të akcioneve kreative protestues në tërë qytetin dhe me anë të grupeve të cilët dhanë kon-



tribut të çmueshëm gjatë punimeve dhe bisedimeve për ndryshimet e klimës. Përkundër dëshprimit rreth përfundimit të diskutimeve, OJQ-të nga CEE nuk do të thotë se janë kundër pozitës së shteteve të tyre, të cilët arsyeshëm iu përmbanin qëndrimit të Unionit Evropian në bisedimet për ndryshimet e klimës. Shumë aktivist hungarez në fakt çmuan lart punën e delegacionit të qeverisë së tyre. Involvimi aktiv i OJQ-ve në bisedimet rreth ndryshimit të klimës, ka filluar në 1992, ka ndihmuar që të tërheqë vëmendjen e mas mediave dhe ka ndihmuar që të që krijohet mendimi se publiku botëror mundet aktivisht të shpreh opinionin e tij për ndryshimin e klimës. Kjo ndoshta është edhe arsyeja se pse OJQ-të kanë më tepër liri dhe çasje në negociatat për ndryshim të klimës se sa ata kanë gjatë debateve për çështje kontraverze mjedisore, siç është energjia nukleare. Por, kjo politikë e "hapjes së deryve" për OJQ-të ka shtuar dushimin tek aktivistët. "Ndryshimet klimatike janë çështje e rëndësishme, por kam ndjenjën se aktorët në bisedimet rreth çështjes së klimës vetëm po mundohen që ti mbajnë të preokupuar njerëzit e OJQ-ve" tha Ada Amon, e cila ishte përgaqësuese e "Hungarian Energy Club" në Hagë. Ajo shton se, edhe pse pjesëmarrja në procesin e bisedimeve për klimën është e hapur, ajo kërkon njohuri të mëdha dhe kohë të madhe për përgaditje - dy resurse të cilat OJQ-ve ju mungojnë. Protestat kreative nëpër rrugët e Hagës dhe në mbledhjen e kaluar në Kyoto, shpesh janë kritikuar se janë kontraproduktive dhe reagim tej mase. Por, aktivistët thonë se protestat e tyre janë për të treguar në problemet dhe çështjet që nuk po preken nga negociatorët. "Dështimi që t'ju përgjigjur pyetjeve të rëndësishme - kjo është problemi i vërtetë, dhe jo akcionet në Hagë", thotë Amon duke

shtuar se negociatorët "nuk duhet që ti gjykojnë demonstruesit vetëm pse nuk mund t'ju përgjigjen pyetjeve të tyre." Ndryshimet klimatike po duket se është konsideruar si çështje e rëndësishme nga OJQ-të në CEE. Por, ka disa OJQ në regjion të cilat përcaktojnë veten e tyre vetëm për çështjet e



ndryshimit të klimës. Çështjet klimatike zakonisht janë trajtuar nga grupet në tri mënyrat tradicionale të aktivitetit të OJQ-ve në CEE: agrokulturë, transport dhe energji. Në rrjetat brenda OJQ-ve, si Climate Action Network (CAN), e cila kanalizon përpjekjet e OJQ-ve të ndryshme në këtë çështje. Por niveli involvimi i OJQ-ve në çështjet e orientuara klimatike ndryshon dukshëm nga shteti në shtet. Përpjekjet për të intensifikuar shkëmbimin e informatave

dhe punës së përbashkët të OJQ-ve në regjionin është marrur përsipër nga CANCEE Co-operation group, REC iniviativës për ndryshimin e klimës dhe tjerëve. Vitin e kaluar, Ministria Bullgare e Mjedisit dhe "Waters" formuan "Borrowed Nature Association", për të zhvilluar një fushatë të titulluar "Save the Ozone" për të ngritur vetëdijen për këtë çështje. REC-u në ndërkohë ka ndihmuar OJQ-të që të fokusohen



në punën rreth ndryshimit të klimës me anë të "Cooperative Grants Program 2000". Duke përdorur këtë fond "National Society of Conservationists" në Hungari, së bashku me "Polish Ecological Club" dhe "Green Library" të Latvisë, shkruan një raport ku krahasuan mekanizmat për "implementimin e përbashkët", që është instrument i shpjeguar në Protokolin e Kyotos për të forcuar përkrahjen për projekte që zvoglojnë gazërat që shkaktojnë efektin e serrës. OJQ-të dhanë raportet e tyre në mbledhjen në Hagë. "Energy Club" përdori grantin e tij për të zhvilluar politikën e rekomandimeve për përdorimin e gazit natyror si burim energjie më të pastër, që do të kontribonte në uljen e emisionit të gazit karbonik në Hungari

(Autori është editor i REC Bulletin-it për Evropën Qendrore dhe Lindore)

Urani i varfëruar në Kosovë



Ka pasur shumë debate kundërthënëse rreth problemeve të mundshme të shkaktuara nga urani i varfëruar (DU) që ishte përdorur gjatë sulmeve ajrore të NATO-s në Kosovë gjatë vitit 1999. Në Nëntorin e vitit të kaluar UNEP (United Nations Environment Programme) bëri një studim në terren, në Kosovë, në mënyrë që të përcaktojë ndikimin e DU në mjedisin jetësor. Në mes të Marsit UNEP paraqiti përfundimet e tyre në një raport, në të cilin pjesërisht bazohet edhe teksti i mëposhtëm.

Çka është urani i varfëruar?

Urani natyror përbëhet prej tre izotopeve radioaktive: U-238, U-235 dhe U-234. Që të jetë më i përshtatshëm për përdorim në termocentralet nukleare, përqindja e U-235 duhet që të rritet. Kjo bëhet gjatë procesit të pasurimit që le uranin e varfëruar si mesoprodukt. Si edhe urani natyror ashtu edhe DU është jo stabil, metal i rëndë radioaktiv që emiton rrezatim jonizues, por që radioaktiviteti i tij është sa 60% i uranit natyror. Kohë e gjysmë zbrërthimit është 4.5 miliard vjet, p.sh. pas kohës së gjysmë zbrërthimit, urani është shëndruar në elemente tjera. DU përdoret në municion (të armëve) për shkak të aftësisë së tij të madhe depërtuese dhe mund të lansohet nga tankset si dhe avionët. Në Kosovë të gjitha projektilet me DU janë gjuajtur nga avionët dhe çdo projektיל përmbanë DU depërtues që peshon 295 g, i vendosur në këllëfin prej aluminit. NATO thotë se 112 vende janë gjuajtur me DU projektile. Rreth 31 000 projektile janë përdorur dhe sasia e përgjithshme e DU, e shpërndarë në tërë Kosovën është rreth 9.3 tonë. Analizat e DU depërtuesve të gjetur, tregojnë shenja të Plutonit dhe U-236. Këto elemente nuk gjinden në uranin natyror, por në mbeturinat e termocentraleve nukleare. Si shpjegim për gjetjen e këtyre elementeve është se, centralet e përdorura për pasurimin e uranit, gjithashtu përdoren për pasurimin e uranit nga termocentralet nukleare, kështu që aparatura e përdorur për këtë qëllim është e kontaminuar me Pluton dhe U-236, e cila më pastaj kontaminon DU.

DU dhe problemet shëndetsore

Kudo që jemi, ne jemi të nënshtruar një sasive të konsideruar të rrezatimit nga urani dhe elementeve të tjera radioaktive. Normalisht, metrat e parë të tokës përmbajnë 2-8 ton uran për km², dhe për shembull uji natyror ka një përmbajtje normale prej 1-100 mikrogram/litër. Rrezatimi nga urani mund të shkaktojë disa lloje të kancerit. Mendohet që rreziku është proporcional me kohën e ekspozimit në rrezatim, që do të thotë se në të vërtetë nuk ekziston sasia e sigurt (e parrezikshme) e rrezatimit, por që rrezatimi normal natyror nuk paraqet ndonjë rrezik të madh. Gjithashtu urani paraqet një rrezik për shkak të toksicitetit të tij kimik që për shembull mund të dëmtojë veshkët në qoftë se absorbimi është i madh. Ka studiues të cilët mendojnë që DU i kontaminuar me Pluton dhe U-236 është shumë më i rrezikshëm për shëndetin se sa ai urani natyror. Ky përfundim mbështetet në atë se Plutoni dhe U-236 nuk janë prezent në mënyrë natyrore në ambient, dhe se trupi i njeriut nuk është i përshtatur në këto elemente, kështu që këto elemente ndikojnë më tepër në organizmin tonë. Megjithatë ende nuk ka vërtetim shkencor për këtë teori që është prezentuar.

Mënyrat e futjes së DU në organizëm

Kur projektili që përmban DU godet cakun ushtarak, një pjesë e tij shëndrohet në pluhur, i cili ndizet në zjarr. Aerosolet e pluhurit janë shumë të vogla dhe do të shpërndahen së bashku me erën. Në qoftë se këto aerosole janë thithur ato

mund të depozitohen në mushkëri dhe të emitojnë rrezatim. Natyrisht që pluhuri bie poshtë në tokë shpejtë dhe shumica e kontaminimit do të qëndrojë në diametrim prej 100 metrave nga caku. Shumica e projektileve nuk e godasin cakun dhe nëse toka është e butë ato do të "varrosen" në tokë. Raporti i UNEP-it nënvizon dy mënyrat kryesore në të cilat DU mund të paraqes rrezik të konsiderueshëm për shëndetin. E para është se në vendet të goditura me DU artileri



● Pozicionet e indentifikuar si caqe të qëlluara me projektile që përmbajnë DU, gjatë konfliktit në Kosovë, në 1999

në sipërfaqe të tokës mund të ketë këllëfa alumini me DU depërtues që mund të kenë koncentrim të lartë të pluhurit të DU-së. Kjo për shembull mund të kontaminon duart e fëmijëve të cilët luajnë në këto vende dhe mund të bartet brenda trupit të tyre përmes gojës. Rreziku tjetër i mundshëm për shëndet është nëse gjenden bunare afër pozicioneve të goditura me DU. Pastaj ekziston mundësia që DU të depërtojë në ujërat nëntokësore dhe tnga aty në bunare. Mostrat e ujit të bunareve, të marra nga UNEP, nuk kanë treguar ndonjë kontaminim me DU, por mund të kalojnë vite derisa DU të bartet nga ujërat nëntokësore në bunare.

Cilat masa duhen të mirren?

Rekomandimet e UNEP-it përfshijnë:

- Në të gjitha vendet në të cilat është përdorur DU, kontaminimi me DU duhet që të studiohet dhe nëse është e mundshme të bëhet. pastrimi dhe dekontaminimi.
- Përderisa kjo nuk bëhet atëherë të gjitha vendet e kontaminuara duhet që të shënohen dhe popullata lokale duhet të njoftohet për rreziqet e mundshme për shëndetin e tyre.
- Bunaret afër vendeve me DU duhet që të monitorohen rregullisht, dhe në rast të prezencës së madhe të uranit, duhet që tu iket përdorimit të ujit të tyre.



Lajme dhe programe nga Zyra e REC-ut në Kosovë

Promovimi i agrokulturës ekologjike

Në pranverë të 2001, zyra e REC-ut në Kosovë, ka filluar të punojë së bashku me fondacionin holandez Avalon, në gjithë Ballkanin në një projekt për promovimin dhe përkrahjen e agrokulturës ekologjike. Në shumë shtete të Evropës Juglindore (EJL) agrokultura ekologjike nuk është në nivelin e duhur, edhe pse ajo ofron zgjedhje të shumë problemeve të shpeshta me të cilat ndeshen shtetet e EJL, siç janë depopulimi i sipërfaqeve rurale, fitime të ulta për fermer, ndotja e tokës dhe ujit nga përdorimi i gabueshëm i pesticideve dhe plehrave si dhe papunësia e lartë. REC-u promovon eko-agrokulturën përshkak të meritave në shëndet dhe mjedis që ajo ka.

Në Kosovë gjatë vitit të parë të projektit synohet që të bëhet njohja me konceptete e agrokulturës ekologjike për OJQ-të mjedisore dhe organizata të fermerëve. Aktivitetet konkrete që priten të realizohen janë:

- 1 ditë workshop me stafin nga Holanda, përgjegjës të projektit Avalon, për 15 pjesëmarrës në Prishtinë, për konceptet themelore të eko-agrokulturës, duke përfshirë edhe shembuj prej shteteve të tjera të Evropës Juglindore (rreth datës 20 Maj, 2001)

- 2,5 ditë workshop me partnerët shqiptarë të projektit (Z. Lavdosh Ferruni), në mundësitë praktike të eko-agrokulturës në Shqipëri dhe Kosovë; kjo është një shkëmbim provojash, ku rastet konkrete dhe shkëmbimi i eksperiencës janë përdorur si metoda për workshope (Qershor, 2001)

- Një fushatë për informim që ka për qëllim prezentimin e koncepteve të eko-agrokulturës tek faktorët relevant në Kosovë

- Pjesëmarrja e 2 kosovarëve, të zgjedhur nga workshopet në vend për trainimin ndërkombtar "Trajnimi i Trajnerëve" që do të mbahet në Shqipëri.

Për informata plotësuese, ju lutemi kontaktoni z. Shkipe Deda.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

Pregaditjet për planifikimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (Local Environmental Actionj Plan, LEAP) është mjet për komunat, qytetet ose vende rurale që të sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm të asaj zone. LEAP detyron politikajt dhe nëpunësit që në mënyrë serioze të marrin parasysh nevojat dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të situatës mjedisore. REC-u ka qenë tejet aktiv në prezentimin e LEAP në shtetet tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore. Dy trajnerë me përvojë për LEAP, nga Maqedonia dhe Shqipëria, do të vijnë në Kosovë për një workshop të përgjithshëm (2,5 ditë) në javën e fundit të Majit, 2001. Në qoftë se komuna e juaj do të jetë vendi më i përshtatshëm për fillimin e punës me LEAP, ju lutem kontaktoni Zyrën REC-ut në Kosovë. Ju gjithashtu mund të tregoni interesimin tuaj tek UNMIK-u, Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit, bashkudhëheqësi Z. Peçanin (pecanins@un.org) ose tek Z. Shala (shalal@un.org). Zyra e REC-ut në Kosovë ka dora-

cak për LEAP në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, si dhe gjithë kalendarin për aktivitetet gjatë këtij procesi.

Vazhdimi i stërvitjeve të shoqatave lokale mjedisore

Katër ciklet e stërvitjeve të shoqatave lokale mjedisore gjatë vitit 2000 dhe pranverës së vitit 2001 kanë qenë shumë të suksesshme. Për këtë arsye edhe Zyra e REC-ut në Kosovë me kënaqësi pret që të vazhdojë procesin e trajnimit të ambientalistëve në Kosovë. Organizata holandeze ICCO ka shfaqur interesim që të financojë vazhdimin e programit të trajnimit, që përfshinë shtjellimin më të detajizuar në temat si menaxhimin e financave dhe gjetja e parave, duke përfshirë temat si identifikimi i projekteve, komunikimi me donatorë dhe përpilimin e projekteve. Ne shpresojmë të organizojmë 4 cikle 2 ditore të stërvitjeve në qytetet vijuese: Gjilan, Pejë, Prizren, Prishtinë. Këto workshope do të mbahen gjatë Tetorit të vitit 2001. Për informata tjera, mund të kontaktoni z. Christy Duijvelaar dhe z. Florina Skeja.

Formimi i rrjetit kompjuterik për OJQ-të mjedisore në Evropën Juglindore

Kosova është e përfshirë në një projekt të madh që do të siguroj qasjen e rrjetës mjedisore ndërkombëtare nëpërmjet mediave elektronike për OJQ-të dhe institucionet mjedisore kosovare. Kosova do të ketë një organizatë qendrore që do të udhëheqë rrjetën elektronike. Kjo organizatë do të përgjegjëse që të gjitha OJQ-të mjedisore vendore dhe institutet të kuptojnë rrjetën elektronike, duke iu ofruar trajnim dhe qasje në rrjet. Ky projekt udhëhiqet nga zyra kryesore e REC-ut në Hungari. Për informata plotësuese, kontaktoni z. Shkipe Deda ose z. Blerim Vela.

Grumbullimi i aluminit dhe Qendra Ricikluese në Prishtinë

Pas një kërkimi intensiv Zyra e REC-ut në Kosovë ka gjetur një vend të përshtatshëm në Prishtinë për hapjen e qendrës së saj për grumbullimin e aluminit dhe riciklimin e tij. OJQ-ja mjedisore "Grupi i Ekologëve të Rinj", ngadal por sigurt do të marrin në dorë menaxhimin e Qendrës. Në Qendër ju mund ti bini kanaqet e juaja prej alumini dhe do të kompenzoheni me 60 fennig/për kilogram alumini. Qendra do të hapet gjatë Prillit 2001, dhe hapja zyrtare e saj do bëhet disa javë më vonë. Z. Hans Nordstrand është personi me të cilin duhet të kontaktoni për këtë qendër.

Vlerësimi strategjik për mjedisin në Kosovë

Sida, Agjensioni Ndërkombëtarë për Zhvillim dhe Bashkëpunim Suedez, ka kontraktuar Zyren e REC-ut në Kosovë që të përgadis botim të "Vlerësimi strategjik për mjedisin në Kosovë". Raporti në gjuhën angleze do të jetë i gatshëm deri në fund të Qershorit 2001, dhe raportet përfundimtare në gjuhën shqipe dhe serbe do të shpërndahen në fillim të Gushtit 2001.



Shkollat mjedisore verore 2001

Menaxhimi mjedisor në perspektivën Evropiane

Shkollat verore do të organizohen nga 17 Korriku deri 3 Gushti i vitit 2001 në Sllovaki. Gjatë tri javëve sa do të zgjas, shkolla verore do të ofrojë pjesëmarrësve njohuri të thukët në lëndën e menaxhimit të mjedisit me fokus të veçantë në zbatimin e tij në mënyrë evropian. E gjithë shkolla verore do të jetë shumë praktikisht e orientuar me një numër të studimeve të rastit, bashkëveprim reciprok dhe aktrim. Lëndët kryesore të shkollës verore të ligjeruara nga profesionist të njohur të evropës do të jenë:

1. Principet dhe Metodat në Menaxhimin Mjedisor
2. Menaxhimi i Projekteve Mjedisore
3. Ekonomia për Menaxhimin Mjedisor

Shkolla verore ka synim mësimdhënës të rinjë në univerzitet dhe studentëve të doktoranturës të kyqur në procesin e mësimdhënjes. Njëri ndër qëllimet e shkollës verore është gjithashtu edhe inkurajimi për implementimin e menaxhimit mjedisor nëpër programet mësimore të pjesëmarrësve.

Shkolla do të jetë ndërkombëtare dhe shkolla verore do të mundohet që të arrijë një balanc të pjesëmarrësve nga shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore, shteteve sapo të pavarësuar dhe shteteve tjera. Kriteri i parë për zgjedhje të pjesëmarrësve do të jetë ajo që ata të jenë mësimdhënës në univerzitet. Kriteri i dytë do të jetë në bazë të lëndës të tyre të studimit, pjesëmarrësit të cilët si lëndë studim kanë mjedisin do tu ipet përparësi. Pasi që gjuha që do të përdoret në shkollë do të jetë gjuha angleze, vetëm pjesëmarrësit me nivel të mjaftueshëm të njohjes së gjuhës angleze do të pranohen. Niveli i gjuhës angleze do të përcaktohet në bazë të vetëvlerësimit dhe studimet personale të tyre duhet që të sillen së bashku me fletë-aplikimin. Studimi personal do të jetë kriter i rëndësishëm për vlerësimin e pjesëmarrësve.

Pagesa për shkollim prej 600 USD, do tu sihurohet një numri të caktuar të aplikuesve në bazë të origjinës së tyre shtetërore. 50% të shpenzimeve të udhëtimit dhe 100% të shpenzimeve për vendosje do tu paguhet një numri të aplikuesve nga shtetet e EQL, SHSP dhe Mongolia. Një shumë modeste gjithashtu do tu sigurohet aplikuesve të zgjedhur. Pjesëmarrësit prej shteteve tjera duhet që vetë ti mbulojnë shpenzimet për udhëtim, vendosje dhe shpenzime të tjera. Këto shpenzime vlerësohen rreth 700 USD për vendosje dhe shpenzime të tjera gjatë gjithë kohëzgjatjes së shkollës verore 2001.

AFATI I FUNDIT PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE ËSHTË 15 QERSHORI, 2001

Për informacione plotësuese dhe fletë-aplikime, kontaktoni:

Academia Istropolitana Nova
 Tel.: 7-4497 0453
 Fax: 7-4497 0454
 E-mail: odvl@ainova.sk
 Web: <http://www.ss2001.sk>

Kampet Verore për të Rinj 2001

Bridges for Education (BFE) organizon kampe verore në gjuhën angleze për verën e vitit 2001. Janë dhjetë kampe në katër shtete: Poloni, Belgjori, Hungari dhe Rumani. Programet mësimore janë të drejtuara kah zgjidhja e konflikteve, krijimit të ekipit, vetëdijësimin interkulturore, debate, vullnetizim, përgjegjësi, iniciativë, udhëheqje dhe argëtim. Moto jonë është, "Studentët flasin 75% të kohës ndërsa mësimdhënësit 25% të kohës", për një mjedis aktiv të nxënjes.

Mosha për aplikim:

Fëmijët të moshës 12-14 vjeç janë të mirëseardhur në kampin Tuchola dhe Ostrowiec Swietokryski, në Poloni, dhe tinxherët të moshës 14-18 vjeç në të



gjitha kampet tjera. Që nga 1994 ne kemi organizuar 55 kampe në tetë shtete, duke dërguar 650 mësimdhënës të shërbejnë 6,000 studentëve nga 27 shtete. Nuk ka nevojë për pagesë për "BFE", por janë disa shpenzime për dhomë dhe ushqimin e studentëve. Kampe të ndryshme mbahen gjatë muajve korrik dhe gusht 2001 dhe një kampim zgjatë 3 javë. Çmimi i qëndrimit për 3 javë në kamp është rreth 250 dhe 300 USD për çdo kamp, varësisht nga vendndodhja dhe shpenzimet vendore. Ju do të gjeni ndihmë financiar shtesë për udhëtimin tuaj në kampim, për shembull nëpërmes Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Informatat:

Për informata plotësuese për Bridges for Education, kontaktoni: Beth Ciesielski, Executive Director, Bridges for Education

E-mail: jbc@buffalo.edu
 Webpage: www.bridges4edu.org



OJQ-të mjedisore nga regjioni

Që nga ky numër i REC Buletinit, çdo herë në këtë faqe do të mund të gjeni OJQ-të simotra të shteteve ku ka përfaqësi REC-u. Shpresojmë që në këtë mënyrë do të nxisimi bashkëpunimin tuaj në nivel regional. Këtë radhë do të bëjmë prezentimin e OJQ-ve nga Shqipëria. Suksese në projektet tuaja të ardhshme. Për informata plotësuese kontaktoni z. Blerim Vela.

"Klubi Ekologjik - Elbasan"

Njohuri të veçanta: Biodiverzitet, mbrojtja e natyrës, agrokultura, pyllëzimi

Adresa: Drejtoria e shërbimeve pyjore, Elbasan,

Personi kontaktues: Ahmet Mehmeti

"Klubi Ekologjik - Fier"

Njohuri të veçanta: Problemet e shkaktuara nga nafta dhe gazi natyror

Adresa: Rr. Thoma Kopace P. parafabrikate, nr. 13, H1/K5, Fier

Personi kontaktues: Adem Latifi

"Shoqata Natyra Ndërkufitare"

Njohuri të veçanta: Menaxhimi pyllor, menaxhimi i faunës së egër, legjislacioni

Adresa: Rr. Pandeli Cale nr. 26, Korçë

Personi kontaktues: Stavri Pllaha

E-mail: wildlife@adanet.com.al

"Shoqata Mjedisore Rinore YLBER"

Njohuri të veçanta: Edukimi ekologjik

Adresa: Rr. Ali Kelmendi nr. 884, Shkodër

Personi kontaktues: Erton Kashta

"Akuarius"

Njohuri të veçanta: Biodiverziteti, publikimet, turizmi, stërvitjet, zhvillimi i shoqërisë

Adresa: Rr. Vaso Pasha P. 2, Ap. 7, Dhoma 4, Tiranë

Personi kontaktues: Adrian Vaso

"Shoqata e Mjedisit Toka - Ajri - Uji"

Njohuri të veçanta: Ujërat termal, mbrojtja e nga erozioni i brigjeve

Adresa: Lgj. 9, Blloku Vasil Shanto, Tiranë

Personi kontaktues: Salvatore Bushati

E-mail: sbushati@yahoo.com

"Shoqata Ekologu i Ri"

Njohuri të veçanta: Edukimi ekologjik,

Adresa: Shkolla e mesme "Sami Frashëri", Tiranë

"Shoqata Masmmedia dhe Mjedisit"

Njohuri të veçanta: Involvmi i mas mediave

Adresa: Rr. G. Domi P. 2/21, Tiranë

Personi kontaktues: Xhemal Mato

Trainim për mjedisistët e rinjë 2001

Mbështetur nga Ministria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit nga Holanda, Fondi Special Japonez, dhe Coca Cola Fondacioni

Flisni Anglisht? Jeni antar i ndonjë organizate joqeveritare që merret me qeshtje të mjedisit? Atëherë "Training for Young Environmental Leaders" është diç për ty!

Përsëri, gjatë vitit 2001, programi shumë i suksesshëm i trainimit të mjedisistëve të rinjë do të organizohet në Zyrën Qendrore të REC-ut në Szentendre, Hungari.

Programi ka për qëllim të përmirësoj aftësitë për menagjim dhe organizim, si dhe kapacitetin e mjedisistëve të rinjë dhe OJQ-ve të tyre në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Shteteve sapo të krijuara. Trainimi zgjatë 4 javë. Qëndrimi i pjesmarrësve është i përbashkët në pansionet e REC-ut, dhe janë tërë kohë në rrjedhë të punës profesionale mjedisore në REC. Mos ngurro, të gjithë Kosovarët me dijeni të gjuhës angleze që janë pjestarë aktiv të ndonjë OJQ-je lokale mjedisore janë të mirseardhur!

Fletëaplikimi duhet të jetë në anglisht dhe të përmbaj :

- Motivi juaj për paraqitje në këtë program
- Cka prisni nga ky trainim?
- Aktivitetet në të cilat doni të përqëndrohëni gjatë periudhës së trainimit, e që janë të dobishme për OJQ-në tuaj
- Ciklin në të cilin paraqiteni (ju rekomandojmë të paraqiteni për më shumë se një cikël të trainimit)
- Si dhe curriculum vitae (CV) në Anglisht, me informatat:
 - Emri dhe Mbiemri
 - Adresa e saktë
 - Numri i telefonit
 - Numri i fax-it dhe adresa e e-mail-it
 - Nacionaliteti
 - Data dhe vendi i lindjes
 - Nr. i Pasaportës
 - Niveli i shkollimit dhe fusha e specializimit
 - Njohja e gjuhëve të huaja
 - Përvoja e punës dhe përvoja relevante
 - Njohja e kompjuterit
 - Emri, adresa, telefoni dhe faxi i OJQ-së suaj
 - Përshkrimi i aktiviteteve tuaja në OJQ
 - Informata për OJQ-në tuaj

Datat e cikleve të trainimit gjatë vitit 2001 janë:

Muajt e trainimit:	Afati i fundit për paraqitje:
Qershor 25 - Korrik 22	Maj 14
Shtator 10 - Tetor 7	Korrik 30
Nëntor 5 - Dhjetor 2	Shtator 24